



Në bazë të nenit 3, par. 1, pika “b” të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe nenit 19, par.1, pika “b” të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.01.2005 merr

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË QENDRËS ADMINISTRATIVE TË KUVENDIT TË KOSOVËS NË KOMPLEKSIN E GËRMISË NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës administrative të Kuvendit të Kosovës, në kompleksin e Gërmisë në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 264 dhe 269, e evidencuar në fletën poseduese nr.168, zona kadastrale e Sofalisë, në sipërfaqe prej 60 arë.

Neni 3

Lokacioni, nga neni 2 i këtij Vendimi, i jepet në shfrytëzim Kuvendit të Kosovës, si ndërrim në emër të lokacionit të evidencuar në fletën poseduese nr.168, ngastra kadastrale nr.233/1 dhe 265, zona katastrale-Sofali, në sipërfaqe prej 29,35 arë.

Neni 4

Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë i Komunës së Prishtinës do të bëjë ndryshimet në evidencat kadastrale, në mënyrë që lokacioni i përshkruar në nenin 2 të këtij Vendimi, të evidencohet në emër të shfrytëzuesit- Kuvendit të Kosovës, ndërsa lokacionit të përshkruar në nenin 3, t’i jepet statusi pronësoro-juridik që kishte lokacioni nga neni 2 para miratimit të këtij Vendimi.

Neni 5

Lokacionin i caktuar sipas këtij Vendimi, me përmbajtjet e realizuara sipas dokumentacionit teknik, do të inkorporohet në planin e ardhshëm rregullativ të kompleksit të Gërmisë.

Neni 6

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit për lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejeimin e ndërtimit të objektit investiv për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë të Komunës së Prishtinës do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre, të caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.Nr. 351-591/1 dt. 04.02.2005

KRYETARI I KUVENDIT

Ismet Beqiri